



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LUSHNJË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Lushnjë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Bubullim”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 –
Pune ndertimi

**VLERA E FONDIT LIMIT: : 31 613 183.17 (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e
trembëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre presje shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”,i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lushnje, ka hartuar
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a; Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020
“Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi**. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e kërkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të

pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

pika 2.3.1 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

2.4 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P. 3 B (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada)
- N.S. 2 A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaneri, mirëmbajtja e tyre)
- N.S. 4 A (punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)
- N.S. 12 A (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)
- N.S. 14 A (Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e

mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P. 3 B	<i>Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada</i>	Kërkohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Githashtu dhe për punimet që do të kryhen në finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe paisje. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit	21-50
N.S. 2 A	<i>Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre</i>	Kërkohet montimi, mirëmbajtja e impianteve hidrosanitare si dhe e atij kundra zjarrit. Të kompletuara me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Kjo gjë	0-20

		është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit	
N.S. 4 A	punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Do të kryhen ndërtime, mirëmbajtje, ristrukturime të muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi ku përfshihet suvatimi bojatisja dhe punime të ngjashme me to. Kërkohet vendosja në vepër, mirëmbajtja e punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit	0-20
N.S. 12 A	Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit	Kërkohet për montimin në veper të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit	0-20
N.S. 14 A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Kërkohet montimi, dhe ristrukturimi i linjave elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjerë që janë të realizuara ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit	0-20

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies

së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi ose 1 (një) Inxhinier zbatimi në ndërtim
- 1 (një) Teknik Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidraulik (hidroteknikë)
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 2 (dy) Hidraulikë
- 1 (një) Topograf
- 2 (dy) Instalues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse ngrohëse
- 2 (dy) Elektriçistë
- 2 (dy) Shtrues pllakash
- 3 (tre) Suvatues
- 2 (dy) Saldator
- 2 (dy) Bojaxhi për ndërtesa

Per te vertetuar personelin duhet:

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, , deshmi profesionale ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune, diplomat ose kualifikimet per punonjës të specializuar/të kualifikuar,(Hidraulikë, Elektriçistë, Instalues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse ngrohëse, Shtrues pllakash, Suvatues, Bojaxhi për ndërtesa, Saldator, Topograf)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e

kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.4 kapaciteti teknik në DST. Stafit teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.4.2 Një punësim mesatar i të paktën **39 (tridhjetë e nëntë) personave**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjesve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjesve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **39 (tridhjetë e nëntë) personave** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e struktues së kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% të kostos.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshte:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Certifikatë: Sistemi I menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (ISO 45001-2018 e vlefshme) Kërkohet për përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve dhe në respektimin e legjislacionit në fuqi për punësimin dhe kushtet e punës.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do

të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 45001-2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **120 (njëqind e njëzetë) ditë kalendarike**.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Ekskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetshkarkues 5-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine 1-3 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji 5000 l	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	min 750 m ²	Pronësi ose me qera
Betoniere 0.25-0.5 m ³	1 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini fadromë e vogël	1 copë	Pronësi ose me qera
Instrument për punime gjeodezike	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrikë Betoni	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi
Gjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm; leja e transportit e vlefshme dhe fotot perkatëse;
- (b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- (f) Për fabrikën e betonit duhet të paraqitet dokumenti që verteton pronësinë e saj, kontrata e marrjes me qera të saj ose aktmarreveshja për furnizim.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Kamionë vetëshkarkues 5 - 10 ton (copë 1)

Këto mjete do të përdoren për largimin e materialit të gërmuar dhe prishjeve konkretisht për punimet e prishjes sipas preventivit janë 100 m³. Punime Sistemimi të jashtëm kemi gërmim 90 m³ nga këto do transportohen 90 m³

Sjelljen e materialeve të kërkuara Shtresë çakulli me trashësi 10 cm 441 m², shtresë stabilizanti me trashësi 5 cm 441m². nënshtresë zhavori 84 m³.

Kamioncinë 1 -3 ton (copë 2)

Mjet që përdoret për transportin e materialeve të imëta dhe transportin e materialeve të ndryshme brenda kantierit. Konkretisht në preventiv kemi zërat FV hekuri betony periodik 2.2 ton, Të gjitha zërat që përfshihen në punime çatie, shkallë montazhi mermeri, shtresa termoizoluese, plintuse dhe pllaka gres importi

Eskavator me goma (copë 1)

Për gërmimin e materialeve në sistemimin e jashtëm, 90 m³ gërmim

Autopompë betoni (copë 1)

Për hedhjen e betonit nga autobetonieria në objekt.

Autobetoniere (copë 1)

Për transportin e betonit të marrë nga nyjet e prodhimit të betonit si dhe për të patur cilësi të betonit gjatë transportit. Në preventiv kemi 88.5 m³.

Mini fadromë e vogël (copë 1)

Për punime në territore ku është e pamundur futja e makinerive të rënda .

Depozitë uji 5000 L (copë 1)

Për mbajtjen e sasisë së nevojshme të sasisë së ujit që nevojitet për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen konkretisht: për përgatitjen e llaçit të suvatimit, shtresat niveluese, njomjen e betonit për mosplasaritjen e tij, njomjen e inerteve për mos krijimin e pluhurave

Pompë suvatimi (copë 1)

Për zërat e punimeve të suvatimit që janë në preventiv. Në preventiv kemi 2122 m² suva gjithsej

Skeleri (min 750 m²)

Sipas preventivit dhe grafikut të punimeve Për rikonstrukcionin e fasadës së jashtme te objektit këkohet vendosja e skelerisë me te gjithë përbërësit e saj si shkallë, rrjetë mbrojtëse, për vendosjen e gjithë elementëve të sistemit kapot si dhe për lyerjen e saj.

Betoniere 0.25 – 0.5 m³ (copë 1)

Per realizime në sasi dhe detaje te vogla betoni si dhe llaçin e suvatimit, shtresat niveluese qe janë në preventiv.

Autovinc (copë 1)

Objekti që do të rikonstuktohet është 2 KT. Per transportin e materialeve vertikalisht kërkohet një vinç për lehtësi në punime si dhe për përfitim në kohë.

Gjeneratorë (copë 1)

Për sigurinë e energjisë së vazhdueshme elektrike gjatë procesit të punimeve në objekt. sipas zërave të preventivit kemi punime saldimit të elementëve

Instrument per punimet gjeodezike (cope 1)

Pajisje për piketimin dhe kuotimin e sistemimit dhe kanaleve të drenazhimit. Në preventiv kemi zëra për sistemimin e territorit dhe gjithashtu dhe punimet e drenazhit. për vendosjen e kuotave sipas projektit dhe për një rrjedhshmëri të ujërave kërkohet ky instrument që topografi të vendosi kuota sa më të sakta.

Saldatrice (copë 2)

Për saldimitin e kangjellave të dritareve të katit përdhe dhe kangjellave të rrethimit të cilat janë zëra në preventiv.

Fabrikë betoni (copë 1)

Prodhimi I betonit te kryhet ne fabrike per te ruajtur nje cilesi dhe uniformitet ne kohezgjatje te prodhimit te tij. në baze të preventivit janë 88.5 m³ beton për tu sjellë në kantier

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit(shtojca8) gjatë fazes së ofertimit.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jete kusht s'kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën respektive janë hartuar dhe venë në dispozicion për njësinë e prokurimit nga Grupi i Punës, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor me Nr.17 Prot. datë 24.01.2024

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar së bashku me dokumentat e tenderit të hartuara nga specialistët e fushës . pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Lushnjë, në përputhje me detyrat funksionale që ajo ushtron.

- Fondi limit për këtë prokurim është përlogaritur nga specialistët e fushës mbështetur në:
-

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”
- Udhëzimin nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- Kodet e profesionit janë bazuar në vendimin nr.514, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kesaj veprë sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.

NJËSIA E PROKURIMIT: